 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP.

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës.....
Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve
Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës.....
Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial
Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike
Shtojca 6. Formulari i sasisë dhe Grafiku i lëvrimit
Shtojca 7. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve
Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit
Shtojca 9. Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....
Shtojca 10. Formulari i Njoftimit të Fituesit.....
Shtojca 11. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)	
Shtojca 12. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër	
Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)	

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]**;
 - Çmimi total i shumatores së çmimeve për njësi, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]**;

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

- Çmimi total i shumatores së çmimeve për njësi, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Arti kulli	Përshkrimi i mallit	Njësi	Sasia e pritshme	Çmimi për njësi	Çmimi total për artikull (4 x 6X)
1.	Sheqer	kg	1150		
2.	Vaj luledielli	litër	750		
3.	Vaj Ulliri	litër	100		
4.	Makarona	kg	1751		
5.	Oriz	kg	1550		
6.	Vezë	kokërr	25000		
7.	Biskota	kg	400		
8.	Niseshte	kg	90		
9.	Çokokrem	kg	300		
10.	Kripë	pako	202		
11.	Çaj natyral	kg	15		
12.	Reçel	kg	300		

13.	Salcë domatesh	kg	60		
14.	Miell	kg	700		
15.	Sodë buke	kg	10		
16.	Konfleksa për fëmije	kg	98		
17.	Trahana	kg	60		
18.	Supë pule (6 copë)	pako	500		
Shumatorja e çmimeve për njësi					
				Çmimi total (Mallrat) _____	
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

*** Shënim:**

Duke qënë se Autoriteti Kontraktor e ka objektivisht të pamundur që të përcaktojë saktë sasi të që do të prokurohen, pavarësisht se ka kryer një parashikim për sasi të që mund të ketë nevojë gjatë zbatimit të marrëveshjes kuadër, këto sasi janë vetëm orientuese, ku si rrjedhojë në zbatim të ligjit **Nr.162/2020, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin publik¹”, nenit 52 i tij, bazuar në përcaktimet e nenit 62 pika 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), si dhe pikës 5.3 të Udhëzimit **nr. 06, datë 16.01.2018** “Për Përdorimin e Marrëveshjes Kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” (i ndryshuar) të APP-së, për qëllime krahasimi, **vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi, në përputhje me kriterin e përcaktuar në pikën 4.3 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të kësaj DST-je.**

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimi i mallrave/ artikujve ushqimor:

“SHEQER”

TREGUESIT “Organo- Leptikë”

1. Pamja e jashtme: Pluhur i përbërë nga kristale të imta dhe të njëjta, pa lëndë të huaja, i derdhur, i thatë në të prekur dhe të mos ngjitet.
2. Ngjyra: E bardhë dhe me shkëlqim.
3. Shija dhe era: Shije e ëmbël, pa shije dhe erë të huaj kur është kristal dhe kur tretet në ujë të pastër.
4. Tretshmëria: Të tretet plotësisht në ujë, tretësira e tejdukshme dhe pa ngjyrë.

TREGUESIT “Fiziko- kimikë”

Treguesit teknikë:

1. Lagështira: 0.074 %
2. Polarizimi: 99.62 %
3. Hiri: Jo më shumë se 0.07 %
4. Lëndë reduktuese (Sheqer invert): jo më shumë se 0.1 %

AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Amballazhimi: I paketuar me pako letre me peshë 1 kg, i etiketuar.

MARKETIMI

1. Emërtimi i prodhuesit
2. Emri i produktit
3. Pesha neto ose vëllimi i produktit
4. Data e prodhimit
5. Data e skadencës
6. Kushtet e veçanta të ruajtjes
7. Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të nmdjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.
8. Malli të shoqërohet me certificate origjine dhe raport analize të laboratorit.

“VAJ VEGJETAL LULE DIELLI I RAFINUAR” (STASH 2121- 87)

TREGUESIT “Organo- leptikë ”.

1. Pamja në 20⁰ C: Lëng vajor, i qartë pa depozitime

-
2. Ngjyra: E verdhë e lehtë
 3. Era dhe shija: E mirë, karakteristike e vajit lule dielli, pa shije dhe erë të huaj e të ranciduar.

TREGUESIT “Fiziko- Kimikë”

1. Aciditeti: Jo më shumë se 0.4 mg KOH/ gr Vaj ose në Acid Oleik 0.2 KOH/ gr / 100 gr vaj.
2. Lagështia dhe lëndët fluturuese në 105⁰ C: jo më shumë se 20 %
3. Dendësia relative në 20⁰ C: 0.918- 0.923 %
4. Numri i sapunifikimit (mg KOH/ gr vaj 188- 194)
5. Treguesit e refraksionit: 1467- 1469
6. Treguesi i jodit: 110- 143
7. Lëndë të pasapunifikueshme: jo më shumë se 15 gr/ kg

AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Vaj lule dielli i rafinuar do të ambalazhohet në shishe plastike me vëllim 1 ose 5 litroshe, të mbyllura me tapë plkastike me vidhëzim hermetic të kapsuluara me shirit PVC me stampën përkatëse.
2. Mbi çdo shishe do të vendoset etiketa në të cilën do të shënohet emërtimi i plotë i mallit dhe data e prodhimit.

MARKETIMI

1. Emërtimi i prodhuesit
2. Emri i produktit
3. Pesha neto ose vëllimi i produktit
4. Data e prodhimit
5. Data e skadencës
6. Kushtet e veçanta të ruajtjes
7. Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.
8. Data e skadimit ose afati I përdorimit që do të jetë 18 muaj nga data e prodhimit dhe e urnizimit në institucion.
9. Shishet do të ambalazhohen në kuti kartoni të mbyllura mire.
10. Malli të shoqërohet me çertifikatë dhe raport analizë të laboratorit.

“VAJ ULLIRI”; STASH 102- 87

TREGUESIT “Organo- leptikë”

1. Pamja e jashtme: të jetë e kthjellët dhe pa asnjë turbullirë.
2. Ngjyra: të jetë e verdhë deri në lehtësisht jeshile.
3. Shija dhe era: karakteristike të vajit të ullirit. Nuk duhet të përmbajë lëndë të huaja, të jetë i rafinuar.

TREGUESIT “Fiziko- Kimikë”

-
1. Aciditeti: Nuk duhet të kalojë 0.5 %

AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Ambalazhimi duhet të jetë në shishe 0.5- 1 litërshe qelqi ose plastike transparente me etiketë ku të shënohen standartet.
2. Nuk duhet të jetë i përzier me vajra të tjerë dhe konservantë.

MARKETIMI

1. Emërtimi i prodhuesit
2. Emri i produktit
3. Pesha neto ose vëllimi i produktit
4. Data e prodhimit
5. Data e skadencës
6. Kushtet e veçanta të ruajtjes
7. Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.
8. Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raport analize të laboratorit.

“MAKARONA”

TREGUESIT “Organo- leptikë”

1. Forma: makarona spageti me gjatësi 25- 30 cm, me diametër 2- 2.5 mm dhe makarona për supë me forma të ndryshme.
2. Pamja e jashtme: Në formë të rregullt, të plota me sipërfaqe të lëmuar deri lehtësisht të ashpër.
3. Pas zierjes, makaronat të jenë elastike, të mos qulloren, të mos çahen dhe të mos krijojnë shkumë.
4. Ngjyra: E bardhë, me nuance të verdhë, në thyerje qelqore me jo më pak se gjysma e sipërfaqes së seksionit.
5. Era dhe shija: E mirë, karakteristike e makaronave pa shije të hidhur, të thartë, të mykur dhe pa çfarëdo ere dhe shije tjetër të huaj.

TREGUESIT “Fiziko- Kimikë”

1. Lagështia: jo më shumë se 13 %
2. Aciditeti: Acid Sulfurik jo më shumë se 0.16 %
3. Rritja e vëllimit pas zierjes jo më pak se 2 herë.
4. Insekte dhe dëmtues të tjerë nuk lejohen.

AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Makaronat të jenë të ambalazuara me qese polietileni nga 0.5- 1 kg, me etiketë ku të shënohen standartet, të mos jenë të miellzuara.
2. Të tregohet koha e zierjes dhe të shënohen standartet.

MARKETIMI

-
1. Emërtimi i prodhuesit
 2. Emri i produktit
 3. Pesha neto ose vëllimi i produktit
 4. Data e prodhimit
 5. Data e skadencës
 6. Kushtet e veçanta të ruajtjes
 7. Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.
 8. Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raport analize të laboratorit.

“ORIZ”

TREGUESIT “Organo- leptikë” (Kategori I.)

1. Pamja e jashtme: Kokrra të shëndosha, të pastra, të zhveshura tërësisht nga lëvozhga e orizit, pa shije dhe erë myku ose prishje.
2. Ngjyra: e bardhë, lejohen kokrra me nuance ngjyre të verdhë.
3. Era dhe Shija: Karakteristike e orizit të shëndoshë pa shije të thartë, të hidhur, pa erë të mykur dhe erë tjetër të huaj.

TREGUESIT “Fiziko- Kimikë”

1. Lagështia: 12.8 %
2. Aciditeti 0.081 %
3. Lëndë të huaja: jo më shumë se 0.4 %
4. Kokrra të thyera më të vogla se gjysma jo më shumë se 12 %
5. Lëndë minerale nuk lejohen
6. Kokrra të verdha jo më shumë se 4 %
7. Kokrra të pazhveshura nuk lejohen
8. Të mos përmbajë dëmtues të gjallë ose të ngordhur

AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Amballazhimi duhet të jetë i paketuar në qese, me peshë 1 kg, i etiketuar, me afat skadimi deri në 1 vit, i shoqëruar me fletë analiza
2. Orizi i cilësisë së parë duhet të ketë më pak se 30 % të kokrrave të copëtuara, të mos jenë të miellzuara.

MARKETIMI

1. Emërtimi i prodhuesit
2. Emri i produktit
3. Pesha neto ose vëllimi i produktit
4. Data e prodhimit
5. Data e skadencës
6. Kushtet e veçanta të ruajtjes

-
7. Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.
 8. Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raport analize të laboratorit.

“VEZE PULE”

TREGUESIT “Organo- Leptikë”

1. Pamja e jashtme: e pastër dhe pa plasje. Lejohet ndotje të lehta
2. Dhoma e ajrit (lartësia), jo më shumë se 9 mm
3. E bardha e vezës: e dendur, e kulluar dhe e pastër pa njolla gjaku (të kontrolluar në ovoskop)
4. E verdha e vezës: Kompakte e ndodhur në pozicionin qendror pak e lëvizshme. Lejohet devijim i vogël nga pozicioni qendror.
5. Era: pa erë prishjeje dhe erë tjetër të huaj
6. Masa: jo më pak se 40 gr

AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Vezët ambalazhohen në kartona fole me kapacitet 30 vezë secila dhe në çdo kuti kartoni vendosen 12 copë kartona fole.
2. Mbi çdo amballazh vendoset etiketa ku shënohen:

MARKETIMI

1. Emërtimi i ndërmarrjes prodhuese
2. Sasia
3. Data e prodhimit

“BISKOTA”

AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Të jenë të paketuara të ndara në pako me 20 copë secila.
2. Mbi amballazh vendoset etiketa ku të shënohen standartet.
3. Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga amballazhi.
4. Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë, të pëlqyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
5. N. q. s është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga amballazhi.
6. Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
7. N.q.s gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar, duhet të përdoret një etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
8. Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër, shënimet e detyrueshme duhet të jenë pike për pikë si të etiketës origjinale.

MARKETIMI

1. Emërtimi i prodhuesit
2. Emri i produktit
3. Pesha neto ose vëllimi i produktit
4. Data e prodhimit
5. Data e skadencës
6. Kushtet e veçanta të ruajtjes

“NISESHTE”

TREGUESIT “Organo- leptikë”

1. Ngjyra: e bardhë
2. Era dhe shija: karakteristike e niseshte së misrit, pa erë myku, pa shije të hidhur të thartë dhe pa erë e shije të huaj.

TREGUESIT “Fiziko- Kimikë”

1. Lagështia: jo më shumë se 8 %
2. Aciditeti: i shprehur në lëndë absolutisht të thata jo më shumë se 0. 100 %
3. Lëndë minerale nuk lejohen
4. Mikroorganizma patogjene, infestime dhe dëmtues hambari të gjallë, nuk lejohen

AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Amballazhimi dhe transportimi: në pako letre 0. 5 kg. Mbi amballazh vendoset etiketa ku të shënohen standartet.
2. Etiketa e produktit të amballazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga amballazhi.
3. Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë, të pëlqyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
4. N. q. s është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e amballazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga amballazhi.
5. Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
6. N.q.s gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar, duhet të përdoret një etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
7. Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër, shënimet e detyrueshme duhet të jenë pike pë pike si të etiketës origjinale.
8. Malli të shoqërohet me certificate origjine dhe raport analize të laboratorit.

MARKETIMI

1. Emërtimi i prodhuesit
2. Emri i produktit
3. Pesha neto ose vëllimi i produktit
4. Data e prodhimit

-
5. Data e skadencës
 6. Kushtet e veçanta të ruajtjes

“ÇOKOKREM”

1. Çokokremi të jetë cilesi ekstra, mase homogjene në trajte kremi me kakao, lajthi, qershi, dhe qumësht pluhur, pa konservues.
2. Përberesit: Qumësht pluhur, sheqer, yndyrna 26% Kakao, lajthi 10 – 12%.
3. Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.
4. Ambalazhimi hermetik me vazo plastike me peshe 1 Kg. me etiketë.

“KRIPE E JODIZUAR”; (STASH 1437/ 01. 07. 1995)

TREGUESIT “Organo- leptikë”

1. Lloji: kripë ushqimore përpunuar dhe e bluar për përdorim në guzhinë.
2. Ngjyra: e bardhë
3. Era dhe shija: e kripur pa shije dhe erë të huaj
4. Pamja; masë kokrrizore

TREGUESIT “Fiziko- Kimikë”

1. Imtësia: 0. 2- 2 mm
2. Klorur Na në lëndën e thatë: jo më pak se 98 %
3. Klorur Mg në lëndën e thatë, jo më shumë se 0. 3 %
4. Sulfat Mg në lëndën e thatë, jo më shumë se 0. 9 %
5. Sulfat Ca në lëndë e thatë, jo më shumë se 0. 2 %
6. Lëndë të patretshme në lëndën e thatë, jo më shumë se 0. 3 %
7. Lagështirë: jo më shumë se 1 %
8. Jodur kaliumi: 50+ -3 mg/ kg
9. Kripa të plotësojë të gjithë kërkesat higjieno –shëndetësore dhe normat e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Ambalazhimi të bëhet në qese të pastër ose polietileni ushqimorë, pasha 0. 5- 1 kg.
2. Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shpëputet nga ambalazhi.
3. Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë, të pëlqyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
4. N. q. s është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.
5. Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.

-
6. N.q.s gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar, duhet të përdoret një etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
 7. Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër, shënimet e detyrueshme duhet të jenë pike pë pike si të etiketës origjinale.
 8. Malli të shoqërohet me çertifikatë origjine dhe raport analize të laboratorit.

MARKETIMI

1. Emërtimi i prodhuesit
2. Emri i produktit
3. Pesha neto ose vëllimi i produktit
4. Data e prodhimit
5. Data e skadencës
6. Kushtet e veçanta të ruajtjes
7. Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

“ÇAJ MALI” (Natyral)

TREGUESIT “Organo- leptikë”

1. Lloji: çaj mali
2. Era dhe shija: erë dhe shije normale karakteristike e çajit
3. Cilësia: të jetë cilësi e parë, i pastër nga barishtet dhe papastërti, pa lagështi.
4. Ngjyra: të jetë karakteristikee tij e gjelbërt e lehtë.

AMBALAZHIMI

1. Ambalazhimi: të jetë i ambalazhuar në qese.

“RECEL”

TREGUESIT “Organo- leptikë”

1. Lloji: Reçel, cilësia e parë.
2. Pamja e jashtme: jo e shëndritshme, e pasheqerosur, me sipërfaqe të njëllojtë, ku shenja myku dhe fermentimi nuk lejohen, pa pjesë të djegur, fletë fruti, fara dhe pjesë të fermentuara.
3. Ngjyra: e njëllojtë, karakteristike e frutave të përdorura të ziera me sheqer.
4. Shija dhe era: erë e pëlqyeshme, karakteristike e frutit që mbizotëron në përzierje, pa erë të huaj. Shija të jetë e pëlqyeshme, e ëmbël pa shije karamelizimi e fermentimi, pa shije të hidhur ose çfarëdo shije tjetër të huaj.

TREGUESIT “Fiziko- Kimikë”

1. Lëndë reduktuese (sheqer invert): jo më shumë se 0.1 %

-
2. Lagështia: jo më shumë se 0.16 %
 3. Hiri: jo më shumë se 0.07 %

AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Amballazhimi: të jetë i ambalazhuar hermetikisht në kavanoza qelqi, apo plastike me peshë 1-5 kg, me etiketë, ku të shënohen standartet.

MARKETIMI

1. Emërtimi i prodhuesit
2. Emri i produktit
3. Peshë neto ose vëllimi i produktit
4. Data e prodhimit
5. Data e skadencës
6. Kushtet e veçanta të ruajtjes
7. Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raport analize të laboratorit.

“MIELL GRURI” (STASH 1455/ 87)

TREGUESIT “Organo- leptikë”

1. Lloji: miell gruri me rreze 80 %
2. Ngjyra: e bardhë me nuance të lehtë në të verdhë në varësi të llojit të grurit.
3. Pjesëzat e himeve janë të padukshme me rreze 80 %.
4. Era dhe shija: erë karakteristike e miellit të grurit, pa erë myku, pa shije të hidhur, të thartë dhe pa erë e shije të huaj. Nuk lejohen kërcitje.

TREGUESIT “Fiziko- Kimikë”

1. Lagështira: jo më shumë se 14 %
2. Aciditeti: i shprehur në acid sulfurik absolutisht të thata, jo më shumë se 0.115.
3. Hiri: i tretshëm në acid klorhidrik 10 %, në lëndën absolutisht të thatë, jo më shumë se 0.1 %.
4. Mbitsitja (imtësia e bluarjes): për miellrat e bluar në fabrikat me cilindra; në sitën metalike nr. 54 jo më shumë se 2 % dhe në sitën e mëndafshhtë, jo më shumë se 5 %.
5. Gluteni i njomë, jo më pak se 25 %
6. Lëndë minerale: nuk lejohen
7. Përzierje metalike: plumbi, zinku e bakri nuk lejohen.
8. Lejohet përmbajtja e hekurit në formë thërmijash nën 0.3 mm, jo më shumë se 3mg. g
9. Mikroorganizma patogjene, infestime dhe dëmtues hambari të gjallë nuk lejohen.

AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Amballazhimi: në pako letre me peshë 1 kg. Mbi amballazh vendoset etiketa ku të shënohen standartet.
2. Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga amballazhi.
3. Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë, të pëlqyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

-
4. N. q. s është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e amballazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga amballazhi.
 5. Transporti të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktorët atmosferikë duke zbatuar rregullat higjeno- sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

MARKETIMI

1. Emërtimi i prodhuesit
2. Emri i produktit
3. Pështa neto ose vëllimi i produktit
4. Data e prodhimit
5. Data e skadencës
6. Kushtet e veçanta të ruajtjes.
7. Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.
8. Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raport analize të laboratorit

“SODE BUKE”(STASH 1429- 87)

TREGUESIT “Organo- leptikë”

1. Pamja e jashtme: me sipërfaqe të njëllotë ku nuk lejohen shenja myku dhe fermentimi, pa fara dhe pjesë të fermentuara.
2. Ngjyra: e kuqe, e njëllotë, karakteristikee zarzavatit të përdorur e të ziera.
3. Shija dhe era: me erë të pëlqyeshme, karakteristike e zarzavatit që mbizotëron në përzierje, pa erë të huaj. Shija të jetë e pëlqyeshme, pa shije të hidhur ose çfarëdo shije tjetër të huaj.

TREGUESIT “Fiziko- Kimikë”

1. Përmbajtja e ekstratit të dobishëm: 28 %
2. Aciditeti: jo më shumë se 0.1 %
3. Kripë NaCl: jo më shumë se 1.3 %

AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Amballazhimi: të jetë i amballazhuar hermetikisht në shishe qelqi, me peshë 720 gr, me etiketë ku të jenë të shënuar standartet.

MARKETIMI

2. Emërtimi i prodhuesit
3. Emri i produktit
4. Pështa neto ose vëllimi i produktit
5. Data e prodhimit
6. Data e skadencës
7. Kushtet e veçanta të ruajtjes
8. Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raport analize të laboratorit.

“TRAHANA”

TREGUESIT “Organo- leptikë”

1. Trahana e prodhuar në kushte industriale, e kokrrezuar. Gjatë tregtimit të zbtohen rregullat higjeno-sanitare e veterinarë në fuqi. Të plotësojë treguesit organo-leptik dhe to fiziko-kimik.

AMBALAZHIMI:

1. Në qese të përshtatshme kartoni të veshura brenda ,me etiketa. Të shënohet lloji i produktit dhe emir i subjektit. Ruajtja dhe transportimi në temperaturë 2-8 gradë nga subjekti me mjete figuriferike sipas orarit të kërkuar nga ana jonë.

“SALCË DOMATE”

TREGUESIT “Organo- leptikë”

1. Pamja e jashtme: Të jetë e cilësisë së parë, prodhim domate, e ambalazhuar në shishe qelqi ose kanaçe, ku të jenë të shënuara origjina, data e prodhimit dhe e skadencës. Nga pamja e jashtme të ketë masë të njëjlojtë, jo fibroze pa fara pa copa e lëkura domatesh, pa pjesë të prishura ose të fermentura.
2. Ngjyra: E kuqe deri e kuqe e thellë.
3. Shija dhe era: Me shije dhe erë karakteristike të salcës së domates.

TREGUESIT FIZIKO KIMIK:

1. Të jenë të pranueshme si: aciditeti në kufijt 0.1%; përmbajtja e sheqerit deri në 20%; klorurit të natriumit (NACL) jo më shumë se 1.3-2%.
2. Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

“SUPË PULE”

PËRBËRËSIT:

1. Kripë, niseshte misri, sheqer, shtues arome (glutamate monosodium, disodium inosinate, disodium guanylate), vaj vegjetal, shije pule, ekstrakti i proteinave, rregullatori aciditetit, (acid citrik), kolor (turemik), pjesë.

AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

1. Duhet të ruhet në vende të freskëta të thata dhe pa erë. Data e skadimit dhe numri i Partis duhet shënuar mbi kutinë e ambalazhit.

“KONFLEKSA PËR FËMIJË”

PËRBËRËSIT:

1. Miell misri (94%), sheqer, malt elbi, kripë, shurup glukozit. Mund të përmbajë gjurmë qumështi dhe soje.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Kontraktuesi/ Furnizuesi do të sigurojë furnizimin e mallrave/ produkteve objekt marrëveshje kuadër, ku Autoriteti Kontraktor mund të nënshkruajë kontratat për furnizimin e sasive të mallrave/ produkteve në një sasi, më shumë ose më pak së në tabelën e paraqitur si më poshtë:

Artikulli	Përshkrimi i mallit	Njësi	Sasia e pritshme	Afati
1.	Sheqer	kg	1150	12 (dymbëdhjetë) muaj
2.	Vaj luledielli	litër	750	
3.	Vaj Ulliri	litër	100	
4.	Makarona	kg	1751	
5.	Oriz	kg	1550	
6.	Vezë	kokërr	25000	
7.	Biskota	kg	400	
8.	Niseshte	kg	90	
9.	Çokokrem	kg	300	
10.	Kripë	pako	202	
11.	Çaj natyral	kg	15	
12.	Reçel	kg	300	
13.	Salcë domatesh	kg	60	
14.	Miell	kg	700	
15.	Sodë buke	kg	10	
16.	Konfleksa për fëmije	kg	98	
17.	Trahana	kg	60	
18.	Supë pule (6 copë)	pako	500	

Afatet e lëvrimit:

Lëvrimi i mallrave objekt prokurimi, do të bëhet nga data e lidhjes së kontratave deri në përfundimin e tyre dhe sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor në magazinën e Bashkisë Mat, me mjetet e furnizuesit.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- 2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë ISO 9001. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
- 2.1.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, që vërteton cilësinë e menaxhimit të sigurisë së ushqimit ISO 22000. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2019**, **2020**, dhe **2021**, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur e fondit limit të marrëveshjes kuadër që prokurohet.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2019**, **2020**, dhe **2021**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2021** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, *ku nëse kualifikohet, përpara përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të marrëveshjes kuadër që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një numër minimal prej 2 (dy) punonjësish të punësuar, ndër të cilët 1 (një) shofer dhe 1 (një) punonjës për transportin e mallit, të cilët duhet të rezultojnë në listëpagesa për periudhën 3 (tre) muajt e fundit, në rastin kur automjeti i deklaruar është në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur automjeti disponohet me qera, punonjësi shofer i kërkuar mund të jetë i kontraktuar.

Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, *dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.

-
- Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme, si dhe
 - Leje për drejtimin e mjetit kategoria B, të punonjësit me detyrë “shofer”.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë “Pulari”, në pronësi ose në përdorim, ose me marrëveshje bashkëpunimi/ furnizimi sipas kontratës noteriale, e cila të tregojë qartë lidhjen e zyrtarizuar ndërmjet ofertuesit dhe prodhuesit. Në çdo rast, operatori ekonomik pjesëmarrës për “Pulari”, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Çertifikatë Sanitare Veterinare;
- Liçencë lëshuar nga QKL: (*Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njërrëz (vezë)*); dhe Leje mjedisore – *Për rritjen intensive të shpendëve.*

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë në pronësi ose në përdorim sipas kontratës noteriale ambiente të përshtatshme për magazinimin e mallrave të kërkuara si dhe me ambient frigoriferik e pajisur me leje Higjeno-sanitare, dhe çertifikatë DDD e vlefshme.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera, automjet (ATP) me qëllim transportin e mallit, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të automjetit në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, *dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë:

a) Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

➤ *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose kontrata e shitblerjes; ose kontrata e dhurimit; ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ *Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:*

- Kontratë huaje.

➤ *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*

- Kontratë qiraje.

b) Leje qarkullimi e mjetit.

c) Çertifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,

d) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,

e) Çertifikate për transport mallrash, për mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Raport Analize origjinale ose kopje të noterizuar, lëshuar nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës, për produktet e ofruar, objekt prokurimi.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë, ai duhet të paraqesë vetdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Shënim:

Mosdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s'kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I, Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I:

Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik

(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
